



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI**

Nr. 1294 Prot

Gjirokastër, më 24.09. 2025

**MIRATOI
REKTORI**
Prof. dr. Jaho CANA



Lënda: Hapet thirrja për mbështetjen e studimeve të doktoratës.

Në kuadër të programit "Programi i kërkimit shkencor", administruar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit - AKKSHI" është hapur thirrja për mbështetjen e studimeve të doktoratës.

Nr	Thirrja	Afati i fundit i dorëzimit të projekt propozimit
1	Thirrje për aplikime për mbështetjen e studimeve të doktoratës	15 tetor 2025

Kjo është një thirrje për mbështetjen me fonde të projekteve të studimeve të doktoratës,

1. Objektivat e "Programit të Doktoratës" janë:

- Të nxisë dhe të lehtësojë kërkimin shkencor gjatë studimeve të doktoratës, për transformimin e cilësisë dhe sasisë së kërkimit shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë.
- Të nxisë kërkime që adresojnë sfidat e zhvillimit teknologjik, të cilat zhvillohen në bashkëpunim me industrinë, që çojnë në inovacion dhe startup-e.
- Të nxisë dhe të fuqizojë kulturën e bashkëpunimit me diasporën akademike në kërkim shkencor dhe krijimin e njohurive të reja, thelbësore për arsimin e lartë dhe ekselencën.
- Të lehtësojë kërkime shkencore cilësore nëpërmjet zhvillimit të proceseve kërkimore në bashkëpunim me universitetet e një nga vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të OECD-së ose të G20-ës.

2. Thirrja mbulon fushat prioritare të kërkimit shkencor si më poshtë:

- Biodiversiteti dhe Mjedis
- Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia
- Shëndetësia dhe shkencat mjekësore
- Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit
- Shkencat Sociale dhe Albanologjike
- Uji dhe Energjia.

3. Do të kenë prioritet për financim projektet e studimeve të doktoratës që adresojnë tematika prioritare të zhvillimit social ekonomik të vendit të cilat aplikohen në nënfusha ndërdisiplinare, brenda fushave të përmendura në pikën 2 më sipër, të tilla si:

- a. Big Data; Machine Learning & Data Sciences; Inteligjencë Artificiale; Qytetet Smart.
- b. Teknologjitë Smart për Bujqësinë dhe Industrinë e ushqimit; Potenciali lokal bujqësor në mbështetje të turizmit; Agroturizmi dhe qëndrueshmëria mjedisore.
- c. Përdorimi i teknologjive të avancuara për modelimin 3D të zonave arkeologjike dhe krijimin e realiteteve historike virtuale; Përdorimi i IA në kërkimin e të dhënave historike.
- d. Qasje inovative për të adresuar problematikat e krijuara nga ndryshimet klimatike në burimet ujore dhe prodhimin e energjisë; Qasje inovative për reduktimin e humbjeve të ujit në prodhimin e energjisë; Teknologji inovative në kërkim - zbulim -nxjerrje dhe menaxhim të burimeve minerale.
- e. E drejta dhe mjedisi; E drejta dhe teknologjia.

Kritere të pranueshmërisë për aplikim:

Kanë të drejtë të aplikojnë për financim nga kohorta e parë e programit të “Doktoratës”:

- 1. Të gjithë kandidatët që janë pranuar në një Institucion të Arsimit të Lartë (publik ose jopublik) për të ndjekur studimet e doktoratës gjatë vitit akademik 2023-2024 dhe 2024-2025.
- 2. Kandidatët që janë staf akademik efektiv në Institucionin e Arsimit të Lartë që ka hapur shkollën doktrale ose që janë staf akademik efektiv në një Institucion tjetër të Arsimit të Lartë.
- 3. Kandidatët që nuk kanë përfituar financim nga burime apo skema/programe financimi alternative (nga IAL, nga fondet e AKKSHI-së, financues të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë) për projekt të njëjtë apo të ngjashëm me atë të studimit doktoral.
- 4. Studimi i doktoratës të ketë parashikuar bashkëudhëheqje shkencore me pjesëmarrje nga diaspora akademike;

Thirrjet, manualin e aplikimit dhe afatet e dorëzimit mund t'i gjeni në portalin e AKKSHI:
(<https://nasri.gov.al/thirrje-per-aplikime-per-mbeshtetjen-e-studimeve-te-doktorates/>)

Gjithashtu, mund të kontaktoni me Sektorin e Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor për informacion më të detajuar.

**Zv. Rektore për Koordinimin Ndërkombëtar
dhe Kërkimin Shkencor**

Prof.asoc. Merita Isaraj

